



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 9, datë 14.01.2021

**PËR KUALIFIKIMIN E KANDIDATËVE QË PLOTËSOJNË KUSHTET PËR
KANDIDIM PËR NGRITJEN NË DETYRË NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORIVE TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 47 pika 6, nenin 52 pika 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 90 të Kodit të Procedurave Administrative, në gërmën “k” të nenit 4, nenin 8, nenin 9 pika 3 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me Vendimin nr.200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të kualifikojë kandidatët, që plotësojnë kushtet për kandidim për ngritjen në detyrë në pozicionin e Drejtuesit si më poshtë :

- Artan Madani kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.
- Gentian Habazaj kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.
- Artan Shtrungza kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë.

2. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrën e drejtuesit në prokuroritë ku nuk ka kandidatë të kualifikuar.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI



ANËTAR
VATË STAKA



ANËTAR
ESMERALDA KESHI



ANËTAR
TARTAR BAZAJ

